

C.nr.1022/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, sipas gjyqtarit individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Lulzim Krasniqi, në çështjen juridiko-civile të paditësve N. K. dhe N. K. të dytë nga fshati G. e U. K. L., të cilët me autorizim i përfaqëson Arian Hetemi av. nga Lipjani, kundër të paditurës Komunës së Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Fatime Mustafa av. publike, me autorizim, për shkak të kompenzimit të t'ardhurave personale, vlera e kontestit 3,620.09-€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.15.02.2023, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve N. K. dhe N. K. nga fsh. G. e U. K. L., si e **BAZUAR**, si dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtorati i Arsimit në Lipjan, që paditësve të ua paguajë dhe atë:

Paditësit N. K. në emër të shujtës ditore për 651 ditë pune për periudhën 18.04.2017 e deri më 2020 shumën prej **1,302.00-€**, dhe kamaten e arritshme për këtë shumë në lartësi prej **415.60.-€**.

Paditëses N. K. në emër të shujtës ditore për periudhën 18.04.2017-31.12.2020 shumën prej **1,302.00-€**, dhe kamaten e arritshme për këtë shumë në lartësi prej **415.60.-€**, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën e njëjtë t'ia paguaj shumën prej **455.70.-€**, dhe kamatën e arritshme për këtë shumë në lartësi prej **144.83.-€**, të gjitha këto me kamatë 8 % nga dita e marrjes së aktgjykimit, përjashtimishtë kamatat e arritura në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

II.REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve N. K. sa i përket pagës jubilarë për 20 vite përvojë pune në vlerë prej 249.34-€, kamatëvonesa në shumën prej 18.34-€, si dhe shpenzimet e udhëtimit për periudhën prej 18.04.2017-2020, në shumën prej 455.70.-€, kamatëvonesa në shumë prej 144.83.-€, poashtu edhe kërkesëpadia e paditëses N. K., sa i përket pagës jubilarë për 10 vite përvojë pune në vlerë prej 196.23-€, dhe kamatëvonesës në shumë prej 72.22-€, si e pabazuar.

III. OBLIGOHET e padituara që paditësve t'ua kompensoi shpenzimet e procedurës në kontestimore në shumën prej 846.00-€, në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Naser Kaqara dhe N. K. të dytë nga fsh. G. e U. K. L., në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tijë, kanë ushtruar padi ndaj të paditurës Komunës së Lipjanit, për shkak të kompenzimit të t'ardhurave personale.

Në padi si dhe me parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë, i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi N. K. është në marrdhënie pune si mësimdhënës i Gjeografisë në Gjymnazin "U." në Lipjan, dhe ka kërkuar kompensimin e pagës jubilarë për 20 vite përvojë pune shumën prej 249.34.-€, kamatën e arritshme në shumë prej 18.34-€, në emër të shujtës ditore për periudhën prej 18.04.2017 e deri në vitin 2020, për 651 ditë pune shumën prej 1,302.00, me kamatë vonesë në shumë prej 415.60-€, si dhe në emër të pagës së shpenzimeve të udhëtimit për periudhën dhe ditët e punës së njëjtë në shumë prej 455.70-€, me kamatë vonesë në lartësi prej 144.83-€, për paditësen Naime Krasniqi i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësja është në marrdhënie pune si mësimdhënëse në Gjymnazin "U." në L., dhe ka kërkuar kompensimin e pagës jubilarë për 10 vite përvojë pune shumën prej 196.23.-€, kamatën e arritshme në shumë prej 72.22-€, në emër të shujtës

ditore për periudhën prej 18.04.2017 e deri në vitin 2020, për 651 ditë pune shumë prej 1,302.00, me kamatë vonesë në shumë prej 415.60-€, si dhe në emër të pagës së shpenzimeve të udhëtimit për periudhën dhe ditët e punës së njëjtë në shumë prej 455.70-€, me kamatë vonesë në lartësi prej 144.83-€, të gjitha keto me kamatë 8 % nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit e deri te pagesa definitive, në afat prej 7 ditve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetet edhe më tutje deklarimave të theksuara në padi, dhe seancat e kaluara si dhe precizimit të bërë, duke i propozuar gjykatës që e njehta të aprovohet në tërësi si e bazuar. Më tutje ka shtuar se nga provat e administruara në këtë çështje kontestimore u vërtetua se paditësve ju takojnë pagat jubilarë, shpenzimet e ushqimit për periudhën kontestuese për 651 ditë mësimi, shpenzimet e udhëtimit për vajtje ardhje për periudhën kontestuese në çmimin prej 1.-€, kërkesa këto të cilat paditësve deri më tani nuk janë paguar nga e paditura, e që burojnë nga dispozitat e nenit 35.5, 35.7, 35.8 të KKAK-së, andaj i ka propozuar gjykatës që e paditura të detyrohet ti paguaj këto kërkesa paditëseve mbi bazën e nenin 2 par.2 të KKAK-së aq sa ekspertit ka bërë llogaritjen kërkojmë që paditësit ti paguhen kwo kërkesa.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar sipas TOAK-së, të specifikuar në shkresën për specifikacionit të shpenzimeve.

Në të përgjegjur në padi si dhe në shqyrtimet gjyqësore e paditura e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse me arsyetimin se çështjet e kërkuara në padi janë pa bazë ligjore dhe se paditësit janë të punësuar tek e paditura dhe askund në kontratën e punës nuk ceket se punëtori i gëzon këto të drejta dhe paditësit i kanë nënshkruar këto kontrata dhe janë pajtuar me kushtet e kontratës si dhe detyrimet që i përmban. Poashtu as me Ligjin e Punës i cili rregullon kontestet e punës nuk ceket askund se punëtorëve iu takon kompensime të tilla, andaj kërkesës së paditësit i mungon baza Juridike.

Në fjalën përfundimtare dhe në shqyrtim gjyqësor e autorizuar e të paditësve ka deklaruar se mbetëm pranë pergjigjes në padi dhe kundërshtoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar edhe njëherë gjykatës i propozoj që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave dhe atë me shiqimin dhe leximin e kontratës së punës nr.04-112-813/. e dt.01.09.2017, për paditësin N. K., me shiqimin dhe leximin i vërtetimit të pervojës së punës nr... i dt.27.11.2019, dhe vërtetimi nr.690 i dtës 23.11.2019 për N. K., me shiqimin dhe leximin i vërtetimit për ditët e pranisë në punë nr.../0 i dt.28.01.2022 së bashku me certifikaten e vendbanimit për paditësin N. K., me shiqim dhe leximin e listës së pagave për dy paditësit, me shiqimin dhe leximin e ekspertizës financiare të ekspertit Arian Ibrahimit e datës 06.02.2023, me shiqimin dhe leximin e kontratës së punës nr.04-112-813/. e dt.01.09.2020, për paditësin N. K., me shiqimin dhe leximin i vërtetimit të pervojës së punës nr.../4 i dt.27.11.2019, për N. K., me shiqimin dhe leximin i vërtetimit për ditët e pranisë në punë nr.../3 i dt.28.01.2022 së bashku me certifikaten e vendbanimit për paditësin N. K., me shiqim dhe leximin e vërtetimit të lëshuar nga ndërmarrja G. Trans I datës 20.01.2022 së bashku me kuponin fiskal për dy paditësit, së bashku me vërtetimin e SBASHK-ut e të cilat prova gjykata i administroj dhe i vlerësoj në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ku vërtetoi këtë gjendje faktike:

a). Se paditësi N. K. nga fsh. G. e U. K. Lipjan ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura në Gjimnazin "U." në Lipjan, nga viti 1992- 2003 dhe 2006- tutje si mësimdhënëse, dhe nga periudha 18.04.2017 e deri në vitin 2020 i njëjti ka gjithësejt 855 ditë pune.

b) Se paditësja N. K. nga fsh. G. e U. K. L. ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura në Gjimnazin "U." në L., nga viti 2005 panderprerë - e tutje si mësimdhënëse, dhe nga periudha 18.04.2017 e deri në vitin 2020 i njëjti ka gjithësejt 855 ditë pune.

c) Se për periudhën 18.04.2017 e deri në vitin 2020 paditësja N. K. ka udhëtuar në relacionin G.-L. dhe anasjelltas, për ditët e pranisë në punë dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit prej 70 % e njëjta ka shpenzuar shumë prej 455.70.-€ duke llogaritur edhe kamatën për këtë shumë prej 144.83-€.

Faktin nën a) gjykata e vërtetoi nga kontrata e punës nr.04-112-813/.. e dt.01.09.2017 e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës si dhe vërtetimi e përvojës së punës nr. ../4 i datës 27.11.2019, si dhe vërtetimin e përvojës së punës nr... I dtës 23.11.2019 së bashku me vërtetimin e ditëve të pranisë në punës nr../3 i dt.28.01.2022 për paditësin N. K..

Faktet nën b), dhe c), gjykata i vërtetoi nga kontrata e punës nr.04-112-813/.. e dt.01.09.2020 e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës, si dhe vërtetimi e përvojës së punës nr. ../4 i datës 27.11.2019, me vërtetimin e ditëve të pranisë në punës nr../3 i dt.28.01.2022, me vërtetimi i udhëtimit i lëshuar nga Kompania transportuese “G. Trans” I datës 20.01.2022 së bashku me kuponin fiskal për paditësen N. K., si dhe ekspertiza financiare e ekspertit Arjan Ibrahimimi të dt.06.02.2023, dhe bazuar në:

Me paragrafin 7 të nenit 35 të Kontratave Kolektive parashifet se “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë dhe ate 2.-€ në ditë ”punëdhënsi është i obliguar t’ia paguaj punëtorve në rastet kur punëdhënsi nuk e ka të rregulluar qështjen e ushqimit nepermjet kuzhines, ose restorantit”.

Me paragrafin 5 të nenit 35 të Kontratës Kolektive parashifet se “Punonjësve arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunes përkatëse ku punojnë, iu takon kompensimi prej 70 % të biletës së trafikut urban”.

Me dispozitat e nenit 8 të LMD-së, të R. së Kosovës, parashihet se “Pjesmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Ndërsa me dispoziten e nenit 245 po të njëjtit Ligj parashihet se “Kreditoret në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegjëje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e lartëcekura gjykata vjen në përfundim se e paditura përkundër kërkesës së bërë nga paditësit nuk ia ka paguar këto të drejta që i takojnë paditësve andaj gjykata vendosi që ta aprovoj pjesërishtë sit ë bazuar kërkespadinë e precizuar të paditësit N. K. lidhur me shpenzimet e ushqimit, si dhe kërkespadinë e paditëses N. K. lidhur me shujtën ditore dhe shpenzimet e udhëtimit dhe vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lartësin e kërkesëpadisë, gjykata e caktoi duke pasur parasysh mendimin dhe konstatimin e ekspertit gjyqësorë financiar Arjan Ibrahimimi të dhënë në ekspertizën e hartuar me shkrim të dt.06.02.2023, të cilën ekspertizë gjykata e vlerësoi si ekspertizë profesionale dhe të bazuar në rregullat e profesionit, e të cilës në tërësi gjykata ia fali besimin, sipas së cilës ekspertizë, për periudhën kontestuese prej dt. 18.04.2017 e deri në vitin 2020, paditësit N. K. për 651 ditë punë-mësimi e llogaritur për 2.00-€ për shujtë ditore, në emër të shujtave ditore i është caktuar kompenzimi në shumë prej 1,302.00-€, si dhe kamata në shumë prej 415.60.-€, poashtu edhe për paditësen N. K. për periudhën e njëjtë kontestuese dhe për për 651 ditë punë-mësimi është llogaritur për 2.00-€ për shujtë ditore, në emër të shujtave ditore i është caktuar kompenzimi në shumë prej 1,302.00-€ dhe kamatëvonesa për këtë në lartësi prej për 651 ditë punë-mësimi e llogaritur për 2.00-€ për shujtë ditore, në emër të shujtave ditore i është caktuar kompenzimi në shumë prej 1,302.00-€, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit të paditëses N. K. për në destinacionin G.-L. shumë prej 455.70-€ me kamatëvones 144.83-€

Sa i përket pagës jubilarë për 20 vite përvojë pune të paditësit gjykata erdhi në përfundim se paditësi përvojën e punës nga viti 1992 e deri në vitin 2016 e ka pasur vitet jubilarë në kohën kur nuk ka qënë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk ka pasur asnjë dispozitë ligjore që e njeh

këtë të drejtë, ndërsa përvojen e punës prej vitit 2016 e deri më sot paditësi N. K. nuk e ka mbushur vitin jubilarë prej 10 viteve siq e kërkon KKAK-ja, e njëjat vlëene edhe për kërkespadinë e paditëses N. K. sa I përket pagës për shpërblim jubilarë për 10 vite përvojë pune, sepse edhe kjo në vitin 2005 ka filluar mardhënjën e punës për herë të parë dhe vitin jubilarë e ka mbushur në 2015 në Kohen kur nuk ka egzistuar asnjë dsipozitë në të cilën mbështete kjo e kërkesë. Kurse sa i përket kërkespadsë të paditësit N. K. lidhur me shpenzimet e udhëtimit i autorizuari i paditësit këtë kërkes nuk e ka bazuar në asnjë provë relevante që lidhet me faktin kontestues edhe përkunder obligimit me nenin 7 të LPK-së ku thuhet se: *“palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, për çka gjykata kërkesat e tilla i refuzoi si të pabazuara si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj kundërshtimet e të paditues të theksuara në përgjigje në padi dhe seancën përgaditore, mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pabazuara me arsyetimin se në nenin 46 të Kontratës Kolektive të Arsimit e dt.18.04.2017 dhe nenit 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.22.01.2021 është paraparë që MASHT-i dhe SBASHK-u angazhohen për t'i informuar Komunat qe me kohë te bëjnë planifikimin e buxhetit për zbatimin e këtyre të drejtave dhe po ashtu te angazhohen në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunat me qellim te realizimit të buxhetit të nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Vendimi për kamaten ligjore u bazua në nenin 382 të LMD-së.

Meqenëse palët paditëse e kanë fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet gjykata në pajtim me nenin 452 dhe 453 të LPK-së, e detyrojë të paditurën që paditësve t'ia kompenzoj shpenzimet e procedures kontestimore dhe ate: për përpilimin e padisë, në shumë prej 156.00 €, për pecizimin e padisë shumë prej 156.00.-€, për 2 (dy) seanca gjyqësore të përfaqësuar nga i autorizuari i palës paditëse shumë nga 202.00.-€, në tërësi shumë prej 404.00.-€, në total shumë prej 716.00.-€ sipas TOAK-ës, për ekspertizë financare shumë prej 100.-€ si dhe në emër të taksës për padi në shumë prej 30.-€, apo shumë e përgjithshme prej 846.00.-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për cka është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe nenit 136 të LMD-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN.
C. nr. 1022/20 me dt. 15.02.2023

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtijë aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njejtit, përmes kësajë gjykate.